



EmpowerMed

Mbledhjet Kolektive

Modul Trajnimi





Ky projekt është financuar nga programi I BE për kërkim dhe Inovacion Horizon 2020 nën kontratën me nr 847052.



Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit EmpowerMed – Fuqizimi i grave për të luftuar varfërinë energjitike në Mesdhe

Drejtues Pakete Pune: SOGESCA

Partneri Përgjegjës: ESF

PRODUKTI 2.2: Spanjë
Versioni Final, Mars 2020

AUTOR: ESF

KONTRIBUES: Focus

SHENIM I RENDESISHEM: Riprodhimi i përmbajtjes apo i pjesëve të saj lejohet vetëm me aprovimin e autorëve dhe duke cituar burimin.





TABLE OF CONTENTS

Hyrje në Modul: Mbledhjet Kolektive	4
1. Hyrje: Historiku dhe kuadri ligjor i eksperiencës së Mbledhjeve Kolektive	5
2. Strategjitë për përfshirje: si të identifikohen më mirë nevojat për një përfshirje më të lartë.	6
3. Metodologji dhe strukturë	8
4. Cilat janë rezultatet? Kufizimet/Sfidat përkundër anëve të forta/mundësive	14
5. Komunikimi me personat e prekur.....	16
Shtojca	20



Hyrje në Modul: Mbledhjet Kolektive

Objektivat e të nxënit

Synimi i këtij moduli është ndarja e eksperiencave mbi fuqizimin energjistik përmes mjeteve dhe njohurive të gjeneruara në takimet e grupit të këshilluesve me persoant e prekur nga varfëria energjike.

- Mjete dhe truke të të mësuarit për të identifikuar nevojat dhe ndërtuar mbi angazhimin e pjesëmarrësve
- Të mësuarin e strukturës dhe metodologjisë (lehtësimi, rolet, etj.) së mbledhjeve kolektive për ti përvetësuar sa më mirë.
- Të mësuarit e përfitimeve që mund të vine si rezultat i fuqizimit të personave të prekur dhe sesi të shoqërohen gjatë procesit.

Përmbajtja

- Historiku dhe kuadri ligjor i krijimit të Mbledhjeve Kolektive
- Strategjitë për tu përfshirë: Si të idnetifikohen më mirë nevojat për një përfshirje më të lartë
- Metodologjia dhe struktura e Mbledhjeve Kolektive
- Resultatet, kufizimet/sfidat dhe anët e forta/mundësitë e Mbledhjeve Kolektive
- Komunikimi me personat e prekur





1. Hyrje: Historiku dhe kuadri ligjor i eksperiencës së Mbledhjeve Kolektive

“Analiza e historikut është celësi i planifikimit më përpara të struktures së Mbledhjeve Kolektive. Na lejon të parashikojmë cfarë çështjesh mund të presim, ose situatat që do të përballemi”

Mbledhjet Kolektive të personave të prekur, eksperiencia që po ndahet në këtë modul, ka nisur në 2014 në Barcelonë të Spanjës. Historia sesi kjo nismë nisi ishte se një në 10 veta në Spanjë e kishte të pamundur të ngrohte shtëpinë si duhej. Faktorët e tjerë dhe kuadri ligjor në fuqi në Spanjë në atë kohë, që plotëson historikun, jepen më poshtë.

Direktivat e BE

DIREKTIVA 2009/72/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të energjisë ka qenë legjislacion i BE që në atë kohë duhet të udhëhiqte politikat në Spanjë. Spanja nuk e ka zbatuar këtë direktivë 2009/72 / EC që thekson se duhet të sigurohet një ndarje efektive mes prodhimit, shpërndarjes dhe tregtimit të kompanive elektrike.

Afati për transpozimin e direktivës për vendet e BE ka qenë 3 mars 2011.

-> 15/10/2012 Komisioni paralajmëron Spanjën se nuk e ka përmbushur ende këtë directive.

Ligji 24/2013 mbi sektorin e energjisë

Përkrahur energjinë si një “shërbim me interes ekonomik të përgjithshëm” dhe ka shërbyer për rregullimin e metejshëm të tregut të energjisë. Ajo parashtrohet vështirësi në shkaqet e varfërisë energjitike si çmimi i energjisë.

Ligji 24/2015 i Parlamentit Katalan

Ligji 24/2015 është korniza ligjore që mbron, në nivelin Katalan, personat vulnerabël nga shpërbërjet. Ky ligj u propozua pikërisht nga puna e mbledhjeve kolektive që Aleanca kundër varfërisë së energjisë ka bërë gjatë një viti (nga 2014 deri në 2015). Mbrojtja e këtij ligji ka ndryshuar llojin e çështjeve që mbërrijnë në Mbledhjet Kolektive por është pikërisht ky ndryshim i realizuar me kontekstin aktual që e bën të dobishëm këtë mjet/iniciativë.





2. Strategjitë për përfshirje: si të identifikohen më mirë nevojat për një përfshirje më të lartë.

“Nevojat duhet të identifikohen nga historiku por edhe nga praktika. Gjatë zbatimit të Mbledhjeve Kolektive ne do të identifikojmë nevoja të reja, që vlejné në punën tonë advokuese”

Përpara se të nisë planifikimi apo programimi i mjeteve/nismave si Mbledhjet Kolektive është thelbësore bërja e një vlerësimi të detajuar të nevojave përmes ligjeve të ndryshme dhe analizave historike. Po ashtu dhe bisedat me aktorët kyç që mund të merren me çështjet e personave të prekur duke kërkuar ndihmë apo vlerësim ekonomik.

Nevojat e identifikuar

Nga eksperiencia në Barcelonë, nevojat e identifikuar janë:

- Fatura të papaguara dhe **ndërprerje**. Lidhje të paligjshme
- **Më shumë arkëtime** (tarifim i parregullt, ndryshim tarifash), **ngacmime telefonike**, refuzim kontratash të reja, etj.
- **Mungesë informacioni** i përgjithshëm mbi:
 - Të drejtat tona
 - Kuptimi i faturave tona
- Kompanitë përfitojnë nga **paqëndrueshmëria** e sistemeve tona **burokratike**

Particularly affected groups

Disa grupe preken specifikisht nga varfëria energjitike. Nevoja të veçanta kërkojnë veprime ose materiale specifike. Një shembull i **grupeve me nevoja të veçanta**:

- gratë
- pleqtë
- Popullsia migruese
- Familjet me një prind
- Personat që jetojnë në shtëpi të uzurpuara

Role of mass media, imaginaries and public opinion

Mas media dhe disa administrata shpesh kanë disa lloj imazhesh që duhen adresuar. Përndryshe do të jemi në rrezik të përsëritjes së situates së vulnerabilitetit:

- **Asistencializmi** (pagesa e faturave pa ofruar ndonjë mjet tjetër)
- **Viktimizimi**: njerëzit vihen në rolin e viktimës, duke u akuzuar që shpnezojnë





shumë; në të njëjtën kohë ka përqëndrim pushteti (ekonomik dhe politik) në 5 kompanitë e shërbimit. Zemërimi ndaj ndaj kompanive që nuk përmbushin ligjet mund të jetë force shtytëse për personat që të nisin të ndjekin mbledhjet kolektive.

- o “familjet konsumojnë shumë”,
- o “nuk dine të menaxhojnë shpenzimet e tyre”,
- o “nuk duan të paguajnë”, etj.

Gjithë këto imazhe dhe mendime të gjeneruara nga masmedia, mund të adresohen dhe përballen në mënyrat e mëposhtme:

- Nevoja për **advokim** dhe **komunikim**: media mund të ndihmojë për tju shpjeguar njerëzve sesi ofruesit e shërbimeve po dhunojnë të drejtat, që mund të përdoren për t'i fuqizuar ato që të kenë kurajon për të ndjekur takimet e para të Mbledhjeve Kolektive, të ndiejnë që s'janë vetëm, që është situatë e njëjtë në shoqërinë tone, etj.
- Nevoja për **mbështetje reciproke, fuqizim** dhe formim i njohurive kolektive.

3. Metodologji dhe strukturë

“Struktura e mbledhjeve kolektive i përgjigjet nevojave të identifikuar. Duhet të ruajë një emërues minimal të përbashkët (metodologjia), por disa pjesë mundo të jenë fleksibël, si kundër ndryshon dhe konteksti, ligjet dhe nevojat.”

“Struktura e mbledhjeve kolektive në Barcelonë i përgjigjet historikut, kuadrit ligjor dhe eksperiencës nga rastet më të zakonshme të hasura. Është krijuar bazuar në imazhin dhe pëlqimin e Platformës ndaj dëbimeve raste suksesi.”

Struktura e Mbledhjeve Kolektive

Struktura kryesore e 2 orëve të mbledhjeve kolektive është:

- **[5min] mirëseardhja:** fjalim jo fajësues / fuqizues mundësisht nga dikush i prekur dhe që ka marrë pjesë në takimet e mëparshme
 - Përdorimi i mesazheve si: “jeni në vendin dhe kohën e duhur; ne jemi këtu për t’ju ndihmuar; nuk jemi avokatë, por sëbashku kemi njohuritë dhe mundëmi..., deviktimizimi i pjesëmarrësve, largimi i fajit; të njohurit e faktit që secili ka disa njohuri dhe eksperiencë që duhet tëndahen” etj. Shih shtojcën për shembullin e fjalës së mirëseardhjes.
- **[3min] Kush jemi?** Aleanca, grupimi ose organizata që drejton iniciativën
- **[2min] dhënia e materialeve divulgativ,** për ato që mund të largohen postera apo fletëpalosje në pikat kyçe të mëhallës. Shpërndarja e fletëpalosjes është një përgjegjësi e përbashkët – njerëzit i shpërndajnë në biblioteka me shokët... Vetë mbledhja vendos nëse në takimet e mëparshme ka patur pjesëmarrje “mjaftueshëm” apo duhet të kërkojnë për raste të reja të personave të prekur. Më pas planifikohet një plan shpërndarje: përmes shërbimeve sociale, në hyrje të kompanive furinizuese etj.; kjo shpjegohet më tej në kapitullin e 5. Është e rëndësishme për ta bërë joshëse për personat e rinj për t’ju bashkuar shpërndarjes së materialeve, dhe ato më të vjetrit ofrohen ta bëjnë një gjë të tillë kur nuk ka kandidat.
- **[10min] Hapat e përgjithshëm** që ndërmerren në rastet e zakonshme. Në rastin e Barcelonës dhe Katalonjës është e tillë:
Hyrje e shkurtër e institucioneve që mund të ofrojnë ndihmë për njerëzit dhe mënyra sesi ti përfaqëson.¹

¹ Kjo mund të jetë e ndryshme në cdo vend.

- o **Kompanitë e shërbimit:** zyrat e tyre janë vendi ku personi mund të kërkojë të gjitha informacionet në lidhje me kushtet e tyre të kontratës, faturat në pritje ose detaje të tjera të shërbimit që po marrin. Shumica e njerëzve mund të kenë nevojë të kontrollojnë kushtet e tyre të kontratës (kapacitet më i ulët, ndryshim nga tarifat e tregut të lirë në tarifën e rregulluar, etj.). Gjithashtu njerëzit duhet të jenë në gjendje të aplikojnë për zbritje dhe / ose tarifa sociale në zyrat e ndërmarrjeve të shërbimeve.
- o **Shërbimet Sociale:** këtu situata e cenueshmërisë do të provohet dhe personi do të marrë një dokument të quajtur "Raporti mbi Rrezikun e Përrashtimit të Strehimit". Disa shërbime sociale mund të ndihmojnë gjithashtu njerëzit e prekur në aplikimin për zbritje dhe tarifa sociale.
- o **Zyra e konsumatorit:** është vendi ku drejtohen ankesat, lidhur me shqëputjet e parregullta ose ngacmimet nga kompania, etj.

Në këtë drejtim ekziston një paralajmërim për nënshkrimin e dokumenteve që njerëzit nuk i kuptojnë dhe se ata mund të konsultohen me shoqatat e konsumatorëve ose asamblenë kolektive nëse është e nevojshme. Shpjegohet gjithashtu që shqyçjet janë të paligjshme dhe njerëzit duhet të luftojnë kundër tyre (kjo do të varet gjithashtu nga korniza ligjore sipas rastit). Njohja e frikës nga pafuqia e njerëzve ndaj kompanive të mëdha është thelbësore për të ndjekur hapat e përgjithshëm, duke i bërë të ditur se mund të mos kenë sukses në përpjekjen e tyre të parë për të rimarrë të drejtat e tyre ose për të paraqitur një ankesë, por stimuluese për të luftuar gjithsesi.

- **[5min] plotësim i anketës** (vazhdon gjatë gjithë kohës së mbledhjes kolektive sepse ju jepet pjesëmarrësve të rinj kur hynë, dhe jo të gjithëve në të njëjtën kohë). Shih shembullin e anketës në shtojcë.

Shkurtimisht ju shpjegohet që anketa është anonime dhe të dhënat mbledhen për të krijuar një pamje të situatës së personave që nuk janë në gjendje të raportojnë tek autoritet vendore se çfarë ndodh në realitet. Po ashtu edhe për të organizuar dhe ofruar këshilla më të mira për pjesëmarrësit në Mbledhjet Kolektive. Anketa² i jepet të porsaardhurve, dhe gjithmonë është dikush pranë ti ndihmojë në rast paqartësie.

Kur plotësojnë anketën, mbledhja vazhdon, dhe një person i qëndron pranë për cdo pyetje apo paqartësi. Anketa nuk është e detyrueshme, dhe shumë rrallë mund ta refuzojnë.

- **[1ore 30min] Rastet / Dëshmitë aktuale:** pjesëmarrësit tregojnë rastin e tyre, duke filluar nga ato që kanë ardhur rishtas³ dhe vazhdohet me ato që kanë nevojë për monitorim të hapave të ndërmarra.
 - o Cdo kush që është present është anëtar i mbledhjes dhe ka të drejtë të jape

² Njerëzit që vijnë më shpesh në mbledhje plotësojnë një anketë më të gjatë dhe u kërkohej dhe kopje të faturave. Kjo anketë nuk plotësohet në të njëjtën dhomë, sepse kërkon kohë dhe privatësi. Vetëm 20% e njerëzve marrin pjesë në të, ndryshe nga anketa e pare ku 99% e personave e plotësojnë.

³ Plotësimi i anketave nga ato që vijnë për here të parë (përfshin rënien dakord për administrimin e të dhënave sipas ligjit të Mbrojtjes së të Dhënave)



mendim. Synimi është të jepet informacion dhe udhëzim për personat e prekur, të dinë sesi mund të ndihmojnë veten (Informacioni është pushtet!).

o Procedura më e zakonshme është si më poshtë:

- Kujtoni **hapat e përgjithshëm për të ndërmarrë dhe përshtatur ato me rastin konkret**. Listoni institucionet që duhen adresuar dhe dokumentet e nevojshme
- Kur përgjigjet nuk janë të qarta, anëtarët konsultohen mes tyre, meqë është debat i hapur.

- Ja vlen të mbahet një **rregjistër i hapave të rekomanduara/ndërmarra në cdo rast**, që të mund t'i ktheheni kur është e nevojshme

o Ideja është që këshilla e dhënë, **do të ndiqet nga vetë personat dhe të raportojnë kur të vijnë në mbledhjen e ardhshme pas dy javësh**.

o Pavarësisht këshillave të dhëna, disa raste do kenë nevojë për mbështetje: rastet urgjente ku ka shqetësime nga rrjeti, rastet me kufizime për shkakë gjuhësore ose rastet kur ka probleme mendore; po ashtu dhe rastet kur njerëzit rishfaqen pasi nuk kanë mundur ta bëjnë vetë. Këto diskutohen në përfundim të mbledhjes, për të vendosur se kush dhe kur do ta shoqërojë.

● **[5min]** Marrëveshje të përbashkëta dhe organizim i rasteve që kanë nevojë për **shoqërim në vizita** tek institucionet ose kompanitë; apo denoncime ose veprime virutale.

- o Disa persona kanë nevojë për mbështetje për një kohë më të gjatë, dhe synimi i mbledhjeve është nxitja e tyre të përpiqen vetë si fillim. Por kur rasti është i vështirë, shoqërimi nga dikush bën sens.
- o Kujtohen edhe njëherë hapat që duhet të ndjekë rasti konkret dhe dita/koha kur do të takohen.
- o Së paku dy persona nga asambleja do ta shoqërojnë personin në kompaninë e shërbimit për ta ndihmuar të ushtrojnë të drejtën e tyre. Kjo ndihmon të lehtësohet marrëdhënia me kompaninë; dhe shpesh kompani ndryshon sjellje kur sheh disa njerëz që vijnë vetëm për një rast.
- o Ndonjëherë mund të jene disa raste që kanë të njëjtin problem me të njëjtën zyrë shërbimi.





- **[1 ose 2 orë shtesë] hapësirë për koordinim** por nuk është e detyrueshme, dhe mund të bëhet kur asambleja rritet dhe është e qëndrueshme në kohë. Ka ftesa të herëpashershme për personat të ndjekin sesionet e koordinimit, por normalisht të sapoardhurit nuk qëndrojnë herën e parë.
 - o Në këto hapësira diskutohen **strategjitë e avokimit**, për sa kohë funksionon grupi dhe mund të ndërmerren strategji për përmirësim dhe shpërndarje të materialeve dhe ndërgjegjësim.
 - o Bisedohet edhe për nevojën për **trajnim të brendshëm**. Temat mund të jenë të ndryshme (psh. Si të zhvillojmë veprime të dpd, si të negociojmë me kompaninë, sit ë përdorim rrjetet sociale, sit ë kuptojmë faturën...), por si nevojat dhe temat vendosen së bashku. Gjatë javëve që nuk ka mbledhje (dymujore) mund të zhvillohen trajnimet.
 - o Veprime direkte për kompanitë që nuk përmbushin ligjin mbi mbrojtjen e konsumatorit planifikohen dh diskutohen në këtë pjesë të takimit. Fuqizimi vjen nga rastet reale që ndihmojnë në avokimin me kompanitë. Shpesh atom und të bien dakord të ndryshojnë sjellje në raste të caktuara të pranisë së por kjo krijon një precedent. Po ashtu veprime direkte tek kompani krijojnë ndjenjën e fuqizimit të përkatësisë në një grupim dhe të ndjenjës se **nga mbështetja e përbashkët tek advokimi ka vetëm një – ndonjëherë e vogël, ndonjëherë jo aq e vogël, hap.**



Lehtësimi i Mbledhjeve Kolektive

Metodologjia e mbledhjeve kolektive bazohet në këto parime:

- **Sesione të hapura:** të gjithë janë të mirëpritur
- **Sesione dyjavore,** përherë në të njëjtin vend.
- **Vazhdimësia** midis sesioneve: pritet që personat të shfaqen
- **Ndërhyrje me një drejtim /synim dhe llogjikën e ekspertit** (çdo kush ka diçka për të ndarë mbi eksperiencën dhe çështjen e tij)
 - Çdokush mund të këshilloj ose të japë opinione
 - Studimi i mëparshëm mbi kontekstin duhet të ketë disa përgjigje apo hapa për të rekomanduar
 - Me kohën, më shumë njerëz do të mësojnë mbi këto hapa, megjithëse çdo rast ka veçantit e tij
- Gjetja e zgjidhjeve për çështjet, së bashku, do të thotë **të mësuarit sëbashku nga eksperiencat tona dhe të të tjerëve,**
- Vizitat shoqëruese bëhen atëherë kur këshillat nuk mjaftojnë, kur identifikohet një nevojë specifike, ose kur personi e ka provuar vetë dhe nuk ka sukses

Rolet në Mbledhjet Kolektive

Lehtësimi i mbledhjeve kolektive ka nevojë për rolet⁴ e mëposhtme, megjithëse mund të ndryshojnë sipas nevojave të identifikuara. Ato mund të ndryshojnë dhe me kohën.

- 1 person për fjalën e “mirëseardhjes”
- 1 person për të shpjeguar “kush jemi”
- 1 person për të shpjeguar “hapat që merren në rastet e zakonshme”
- 1 person për të shpjeguar rëndësinë e shpërndarjes së materialeve
- 1 person të mbajë radhën e të folurit.
 - Normalisht ky person mban dhe shënimet për njoftimet në website. Ky postim nuk duhet të përmbajë të dhëna personale, por hapat që këshillohen për cdo rast dhe ndjenjat e pjesëmarrësve në mbledhje.
- 1 person të kontrollojë që anketa plotësohet saktë
- Të paktën 3 vetë të jenë prezent edhe nga mbledhjet e mëparshme dhe që duan të ndajnë eksperiencat e tyre, pikëpamjet dhe mendimet
- 1 ose më shumë veta për shoqërimet (preferohen 2 ose më shumë)
- Ka edhe një ndarje joformale të çështjeve të mbuluar
 - Dikush merret me problemet e ujit, dikush me energjinë/gazin
 - Dikush tjetër mund të jetë më i familjarizuar me shkëputjet dhe parimet e mbrojtjes nga vetë ligji.

⁴ Në fillim disa vetë mund të bëjnë më shumë se një rol, por idealja është të ketë sa më shumë ndarje rolesh



- o Dikush tjetër mund të dijë për tarifatat shoqërore dhe zbritjet, dhe procedurat e aplikimi
- o Dikush di si të adresojë çështjet e banesave të zëna dhe/ose ligjërit të lidhjeve të parregullta.





4. Cilat janë rezultatet? Kufizimet/Sfidat përkundër anëve të forta/mundësive

Rezultatet e vëna re në rastin e Barcelonës janë:

- Fuqizim
- Transformim rolesh
- Krijim i njohurive kolektive
- Ndarje përgjegjësish
- Krijim i një rrjeti me mbështetje reciproke, që zgjat në kohë (vazhdimësi), transformon në të njëjtën kohë me ndryshimet historike (ndarje statike e çështjes).

Gjithsesi, formati i Mbledhjeve Kolektive ka disa pengesa që duhet të merren në konsideratë që të gjeneroj përfshirje më të mire dhe të shfrytëzojë mundësitë e dhëna:

Kufizime/sfida

- Kontekst kompleks dhe ndryshues
- Çështje të pafundme. Edhe nëse Asambleja mban një regjistër për çdo rast dhe ka udhëzime të qarta për secilin prej tyre, ka gjithnjë gjera të reja;
- Ne nuk kemi zgjidhje për cdo gjë!
- Vështirësia e arritjes përtej rasteve të zakonshme dhe të përbashkëta (jo çdo kush di për nismën) → fletëpalosje, punë komunikuese, etj.
- Ndërprerje të caktuara nga pjesëmarrësit: Vartësisht nga situata personale, Vartësisht nga motivimi

Anët e forta/Mundësitë

- Njerëzit e prekur tashmë janë “ekspertë”
- Drejtpërdrejt, lidhur me realitetin në kohë reale, aftësi për të reaguar shpejt (telegram, twitter, veprime direkte, etj.)
- Të menduarit sëbashku për zgjidhje dhe strategji
 - o “Cfarë vlen për mua mund ti vlejë dhe dikujt tjetër”,
 - o “e bëme këtë dhe nuk na eci, ndaj duhet të provojmë dicka të re”, etj.
- Akumulim në kohë i njohurive, etj.
- Ndjesia e të qenurit pjesë e ‘rrjetit’, të një “familje”. Mbështetje emocionale& fuqizim kolektiv në vend të asistencializmit





5. Komunikimi me personat e prekur

Një nga sfidat kryesore të asambleve është përgatitja për punën komunikuese në public, në mënyrë që këto takime njihen dhe arrihet shpërndarje maksimale përmes aktorëve kyç, vendeve dhe medias:

Përmes videove, website dhe medias sociale

<https://www.youtube.com/watch?v=VelpStJ8uel>

www.pobresaenergetica.es

https://twitter.com/APE_Cat



Shpërndarja në vendet kyçe dhe aktorët lokal

Përmes fletëpalosjeve/posterave për shpërndarje në vendet kyçe:

- Markete
- Qendra shëndetësore
- Qendrat e asistencës
- Zyrat e shërbimit social
- Zyrat e punësimit
- Në dalje të zyrave të kompanive të shërbimit

Përveç ofrimit të këtyre materialeve në mbledhjet kolektive, një herë në dy javë bëhet një mbledhje grupit të shpërndarjes së materialeve, në një lagje të zgjedhur, për t'i dorëzuar materialet personalisht, drejtpërdrejt te njerëzit në rrugë, në tregjet, jashtë zyrave kryesore, etj., në mënyrë që të shpjegojnë më shumë detaje nëse është e nevojshme



Dokumente të vlefshme

Puna komunikuese me personat e prekur është e provuar sim ë resultative kur edhe materialet janë të targetuara. Në rastin e Barcelonës “dokumenta të vlefshme” të ndryshme u hartuan frymëzuar nga nevojat e identifikuara. Ato janë formate / terma teknikë që ndihmojnë kapërcimin e kufizimeve:



<https://pobresaenergetica.es/index.php/ca/passos-a-seguir/documents-utills>



Shembuj të “dokumentave të dobishëm” mund të jenë:

- Ankesa për shkëputje lidhje të parregullta
- Ankesa për ngacmime telefonike të rregullta ose ndryshime të kontratave pa leje
- Përmbledhje e kërkesave për të përfituar nga uljet apo tarifat sociale
- Infografika me udhëzimet bazë ose aktorët që duhen adresuar

Tipo de consumidor	Límites de renta mensual (14 pagas) menor o igual a	Límites máximos de consumo (kWh / año / hogar)	Descuento	Plazo de corte del suministro en caso de impago	Quién paga
Consumidor vulnerable					
 Unidad familiar sin menores a cargo o no formar parte de ninguna unidad familiar.	805,67 € / mes	1.380	25%	4 meses	Comercializadoras en función de clientes
 Unidad familiar con un menor a cargo.	1.074,23 € / mes	1.932	25%	4 meses	Comercializadoras en función de clientes
 Unidad familiar con dos menores a cargo.	1.331,27 € / mes	2.346	25%	4 meses	Comercializadoras en función de clientes
 Categorías especiales (violencia de género, discapacidad 33% o +, víctimas del terrorismo, dependencia reconocida de grado II o III, o familias monoparentales).	 1.074,23 € / mes  1.342,78 € / mes  1.611,34 € / mes	 1.380  1.932  2.346	25%	4 meses	Comercializadoras en función de clientes
 Las familias numerosas.	Sin límite	4.140	25%	4 meses	Comercializadoras en función de clientes
 Unidades familiares en las que todos sus miembros que tengan ingresos sean pensionistas del Sistema de la Seguridad Social por jubilación o incapacidad permanente.	Quantía mínima (sin otros ingresos cuya cuantía agregada anual supere los 500€).	1.932	25%	4 meses	Comercializadoras en función de clientes

“Libri i Kuq”

“Libri i Kuq” është një udhëzues për mbledhjet kolektive që përmban një përmbledhje të aspekteve të ndryshme të paraqitura në këtë modul trajnimi, por të targetuar për personat e prekur.





Cfarë përmban libri?

- **Parimet e nismës:** të garantojnë shërbime bazë si energjia përmes fuqizimit
- **Konteksti** i modelit të energjisë në vend/rajon: shpjeguar thjesht, përmes shembujve dhe termave të kuptueshme
- **Kush jemi?** Shpjegim i shkurtër i atyre që drejtojnë nismën
- **Pse Mbledhje Kolektive?** Përfitimet e metodologjisë
- **Si të marresh pjesë?** Mënyrat e pjesëmarrjes në nismë
- **Rastet e zakonshme:** përmbledhje e 4-5 rasteve dhe situatave më të zakonshme dhe hapat për tu ndjekur

Përse shërben Libri?

- Është një udhëzues, **strukture e shkruar** e asaj që ndodh në realitet. Vecanërisht për ato që vijnë për here të pare në mbledhjet kolektive, është shumë e dobishme ta marrin me vete (mbahet në xhep) dhe ta kthejnë më vonë;
- Është **një kujtesë e hapave bazë** që ndërmerren në rastet e zakonshme. Kur ndonjëri ka dyshime, aty gjen përmbledhje të veprimeve për tu ndërmarrë;
- Është një “**manifest**” sesi funksionon një Mbledhje Kolektive dhe sesi lehtësohet (rregullat e lojës).



Shtojca

Fjala e mirëseardhjes

“Mirësevini në Mbledhjen Kolektive të Alenacës ndaj Varfërisë Energjitike (APE). Ju duhet ta dini se që sot e tutje ju nuk jeni vetëm. Jeni në vendin më të mirë të mundshëm. Gjeja e pare që duhet të dini është se APE dhe Mbledhjet Kolektive janë vetëm një mjet. Një mjet që mund tju ndihmoj të zgjidhni disa problem që keni së fundmi lidhur me shërbimet bazë si energjia. Ne neuk jemi një zyrë apo kompani konsulente. Po ashtu nuk jemi zyrë avokatie. Ajo cka do të merrni është përherë një këshillë, jo “çfarë të bëni”. Më pas, varet nga ju si do të procedoni. Vendimi përfundimtar është përherë i juaji.

Duhet ta dini se do ta prezantoni rastin apo situatën tuaj personave që tashmë janë ose në të shkuarën kanë qenë në një situatë të tillë. Kështu ato do e dinë, ne e dimë, se çfarë po kaloni, çfarë po përjetoni kur ju është shkëputur furnizimi me energji dhe ujë; çfarë ndieni kur kompanitë ju ngacmojnë duke ju kërkuar debinë e papaguar; kur ju ndihen të gënyer nga një nga këto kompani. Netë pa gjumë, kur ju mendoni se nuk vleni për gjë, dhe ndjesia sikur bota po ju fundoset.

Ndaj, është e rëndësishme kur paraqisni rastin tuaj të bëni sa më qartë. Asnjë nuk do ju gjykoj. Është shumë e rëndësishme të dihen detajet, hapat që keni marrë për ta zgjidhur, me kë keni folur apo cilin aktor keni adresuar.

Ne do ju shoqërojmë në disa nga hapat që ju do të donit ti bënit për të përmirësuar situatën tuaj, shoqërore, ekonomike dhe mbase emocionale. APE do tju ndihmojë të fuqizoni veten. Nëse ju ngecni në një nga momentet e procesit, mos u merakosni, mbase do të përpiqeni disa here dhe me strategji të ndryshme. Ne do tju shoqërojmë në disa hapa nëse nevojitet, por gjithmonë do ju inkurajojmë ta provoni vetë njëherë. Dhe jeni të mirëpritur të keqteheni në mbledhjet kolektive me më shumë dyshime. Ideja është se kur çështja juaj përmirësohet apo zgjidhet, ju vazhdoni të vini në mbledhje, pasi aktorët dhe kompanitë me të cilët përballemi kanë një fuqi të madhe, dhe së bashku mund të ndërtojmë më mirë njohurinë e përbashkët dhe fuqizojmë për të ndaluar vulnerabilitetin e të drejtave tona bazë. Jemi këtu për të ngritur zërin dhe ushtrojmë të drejtën tone. Për situatën me të cilën po përballemi nuk duhet ta akuzojmë veten.

Mirësevini dhe tani le të fillojmë mbledhjen.



Karta / Anketa e shkurtër

Emri/Logo e organiztës

Kartela e përdorur

Kjo anketë e shkurtër është një kartelë me synim për të ndjekur rastet që marrin pjesë në mbledhje dhe administrimin e duhur të të dhënave. Plotësimi nuk merr më shumë se 5 minuta.

TE DHENA PERSONALE

Emri: **e-mail:**
(emir juaj duhet vetëm për organizim të brendshëm, Nëse preferoni mund të përdorni edhe një nofkë)

Vendi/Qyteti: **Nr Identifikimit:** **Rruga:**
(Nuk ka nevojë të jepen nr I katit apo apartamenti. Ky informacion na dñhmon për vjetërsinë e ndërtesës)

Gjinia: Mashkull Grua tjetër

Cel: **A e përdorni aplikacionin telegram?** Po
Jo (Ky informacion do të duhet për organizimin e mbledhjes së aferme, etj.)

SITUATA FAMILJARE

Numri total i njerëzve që jetojnë në ndërtesë:

Specifikoni numrin e personave në banesë varësisht nga mosha dhe gjinia:

Mosha / Gjinia	Burrë	Grua	Tjetër/jo dyzuar
minoren (0 deri 17 vjeç)			
Adultët (18 deri 64)			
Më shumë se 65			

Nëse ka ndonjë person me aftësi të kufizuara, sa të tile ka?

¿A jeni rregjistruar nga CENSUS?: Po Jo

¿A jeni të rregjistruar A jeni përdorues i rrjeteve sociale (SS)?: Po Jo

A keni një raport mbi situatën e vulnerabilitetit?:

Po Jo Nuk e di çfarë është kjo Nuk do ma japin

Arsyet për refuzimin e raportit:

BANIMI TE DHENA BAZE

SHTËPIA JUAJ: Pronësia: Qera: zënë: tjetër (specifiko):.....

Cili është niveli (temperature adekuate) në shtëpi?

(rehati shumë e ulët: Është ftohtë 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 (komfort i lartë: iNuk është ftohtë në dimër dhe/ose vape në verë) në dimër dhe as ngrohtë në verë)

TE DHENA MBI VARFERINE ENERGJITIKE

Ju jeni i prekur nga cili shërbim / e?:

Ujë

Ndricim

Gaz

Detajoni sitatën e shërbimit tuaj (mund të përzgjidhni më shumë se një):

	Shërbimi është kontraktuar në emrin tim	Shërbimi është kontraktuar në emrin e dikujt tjetër	Lidhje e parregullt	Paralajmërim për prerje	Shërbimi i ndërprerë	Debi e akumuluar	Nuk është e aplikueshme / Nuk e kam këtë shërbim
Ujë							
Ndricim							
Gaz							

Nëse ndonjë nga shërbimet është shkëputur tashmë, shpejgo sa muaj keni pa këtë shërbim:

Detajo kushtet e kontratës tuaj (mund të zgjidhni më shumë se një kuti për rresht):

	Kontratë me tarifa të rregullta	Kontratë me tarifa orare diskriminuese	Tarifa sociale për faturë	Aplikimi për tarifa sociale më është refuzuar	Nuk është e aplikueshme / Nuk e kam furnizimin ose shërbimin
Ujë					
Ndricim					
Gaz					

Si keni kontaktuar?

shokë shtypi/Media rrjetet sociale tjetër (specifiko):

Me çfarë detyrash mund të ndihmohet?

shoqërimi Veprime minuta në rrjetet sociale Tjetër (specifiko):

APROVIM I PLOTE PER ADMINISTRIMIN E TE DHENAVE

[ky tekst varet nga specifikat e cdo organizate]

Data dhe Vendi

Nënshkrimi (ose shenja nëse është virtuale).

Pohimi i BE





EmpowerMed

Fuqizimi i grave në luftën ndaj
varfërisë energjitike në Mesdhe

Trajnimi mbi Mbledhjet Kolektive



EmpowerMed



Përmbajtja:

- Kuadri i mbledhjeve kolektive
- Strategjitë për përfshirje, bazuar në nevojat e identifikuar
- Metodologjia dhe struktura
- Cilat janë rezultatet?
- Komunikimi me njerëzit e prekur
- Informacione dhe materiale për më tej

Kuadri i mbledhjeve kolektive

*“Analiza e situatës është çelësi për të planifikuar më përpara strukturën e mbledhjeve kolektive.
Na lejon të parashikojmë çfarë lloj çështjesh mund të presim, ose situatë që mund të ndeshim.”*

Kuadri i Mbledhjeve Kolektive



POBREZA ENERGÉTICA

Una de cada diez personas en España no puede calentar su hogar

Tras las bucólicas estampas nevadas de estos días hay personas sufriendo por casas que no aíslan bien del frío y muchas familias que no pueden hacer frente a sus facturas de calefacción, luz o agua caliente.

Në Spanjë së paku 1/10 njerëz nuk arrijnë të ngrohin shtëpitë

Kompanitë e shërbimit në Spanjë fitojnë më shumë në Evropë.

BENEFICIOS DE LAS ELÉCTRICAS

Relación entre los promedios de los beneficios de las empresas y EBITDA (ganancia antes de intereses, impuestos, depreciación y amortización) de las principales empresas eléctricas de España, Alemania, Francia y Reino Unido (2013, 2016)

	EBITDA / FACTURACIÓN	RESULTADOS / FACTURACIÓN
ESPAÑA	18%	8%
ALEMANIA	11%	-4%
FRANCIA	23%	4%
REINO UNIDO	7%	1%

Fuente: Observatorio de la Sostenibilidad.

Kuadri i Mbledhjeve Kolektive

DIREKTIVA 2009/72/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të energjisë

Spanja nuk e ka zbatuar këtë direktive 2009/72 / EC që thekson se duhet të sigurohet një ndarje efektive mes prodhimit, shpërndarjes dhe tregtimit të kompanive elektrike.

Afati për transpozimin e direktivës për vendet e BE ka qenë 3 mars 2011.

-> 15/10/2012 Komisioni paralajmëron Spanjën se nuk e ka përmbushur ende këtë direktive

Kuadri i Mbledhjeve Kolektive

Ligji 24/2013 mbi sektorin e energjisë

Përkrahet energjinë si një “shërbim me interes ekonomik të përgjithshëm” dhe ka shërbuer për rregullimin e metejshëm të tregut të energjisë. Ajo parashtron vështirësi në shkaqet e varfërisë energjitike si çmimi i energjisë.

Ligji 24/2015 i Parlamentit Katalan

Ligji 24/2015 është korniza ligjore që mbron, në nivelin Katalan, personat vulnerabël nga shkatërrimet. Ky ligj u propozua pikërisht nga puna e mbledhjeve kolektive që Aleanca kundër varfërisë së energjisë ka bërë gjatë një viti (nga 2014 deri në 2015). Mbrojtja e këtij ligji ka ndryshuar llojin e çështjeve që mbërrijnë në Mbledhjet Kolektive por është pikërisht ky ndryshim i realizuar me kontekstin aktual që e bën të dobishëm këtë mjet/iniciativë.



Strategjitë për përfshirje, bazuar në nevojat e identifikuar



“Nevojat duhet të identifikohen nga konteksti si dhe nga praktika. Gjatë mbledhjeve kolektive ne do të identifikojmë nevoja të reja, dhe do të thellojmë punën tonë në advokim”



Strategjitë për përfshirje, bazuar në nevojat e identifikuara

Nga eksperiencia në Barcelonë, nevojat e identifikuara janë:

- Fatura të papaguara dhe **ndërprerje**. Lidhje të paligjshme
- **Më shumë arkëtime** (tarifim i parregullt, ndryshim tarifash), **ngacmime telefonike**, refuzim kontratash të reja, etj.
- **Mungesë informacioni** i përgjithshëm mbi:
 - Të drejtat tona
 - Kuptimi i faturave tona
- Kompanitë përfitojnë nga **paqëndrueshmëria** e sistemeve tona **burokratike**



Strategjitë për përfshirje, bazuar në nevojat e identifikuara

Disa grupe preken specifikisht nga varfëria energjitike. Nevoja të veçanta kërkojnë veprime ose materiale specifike. Një shembull i **grupeve me nevoja të veçanta** :

- gratë
- pleqtë
- Popullsia migruese
- Familjet me një prind
- Personat që jetojnë në shtëpi të uzurpuara
- ...

Strategjitë për përfshirje, bazuar në nevojat e identifikuara

Mas media dhe disa administrata shpesh kanë disa lloj imazhesh:

- **Asistencializmi** (pagesa e faturave pa ofruar ndonjë mjet tjetër)
- **Viktimizimi** (“familjet konsumojnë shumë”, “nuk dine të menaxhojnë shpenzimet e tyre”, “nuk duan të paguajnë”, etj.)

Edhe nga kjo, mund të identifikohen disa nevoja:

- Nevoja për **advokim dhe komunikim**
- Nevoja për **mbështetje reciproke, fuqizim dhe formim i njohurive kolektive**

Metodologjia dhe Struktura

“Struktura e mbledhjeve kolektive i përgjigjet nevojave të identifikuar. Duhet të ruajë një emërues minimal të përbashkët (metodologjia), por disa pjesë munda të jenë fleksibël, si kundër ndryshon dhe konteksti, ligjet dhe nevojat.”

Metodologjia dhe Struktura

“Struktura e mbledhjeve kolektive në Barcelonë i përgjigjet historikut, kuadrit ligjor dhe eksperiencës nga rastet më të zakonshme të hasura. Eshtë krijuar bazuar në imazhin dhe pëlqimin e Platformës ndaj dëbimeve raste suksesi.”

Metodologjia dhe Struktura

Struktura kryesore:

- 5min -> **minrëseardhja**: fjalim jo fajësues / fuqizues mundësisht nga dikush i prekur dhe që ka marrë pjesë në takimet e mëparshme
- 3min -> **Kush jemi?** Aleanca, grupimi ose organizata që drejton iniciativën
- 2min -> **dhënia e materialeve divulgativ**, për ato që mund të largohen postera apo fletëpalosje në pikat kyçe të mëhallës
- 10min -> **Hapat e përgjithshëm që ndërmerren** në rastet e zakonshme

Metodologjia dhe Struktura

- 5min -> **anketimi**: plotësimi i anketës me të dhëna sociodemografike dhe mbi varfërinë energjitike. Si dhe aprovimi i adminsitrimt të të dhënave bazuar mbi ligjin për mbrojtjen e të dhënave.
- 1h 30min -> **çështjet / dëshmitë aktuale**: duke filluar me ato që vijnë për here të pare dhe më pas me ato që kanë nevojë për monitorim të hapave të lëna nga hera e kaluar.
- 10min -> **shoqërimet**: Marrëveshje / organizim i përbashkët mbi ato raste që kanë nevojë për shoqërim tek kompanitë e shërbimeve.
- **Hapësirë për bashkëpunim të mundshëm**

Metodologjia dhe Struktura

Metodologjia e mbledhjeve kolektive bazohet në këto parime:

- Sesione të hapura: të gjithë janë të mirëpritur
- Sesione dyjavore, përherë në të njëjtin vend.
- Vazhdimësia midis sesioneve: pritet që personat të shfaqen
- Gjetja e zgjidhjeve për rastet + të mësuarit sëbashku



Metodologjia dhe Struktura

- Ndërhyrje me një drejtim/synim dhe llogjikën e ekspertit (çdo kush ka diçka për të ndarë mbi eksperiencën dhe çështjen e tij)
 - Çdokush mund të këshilloj ose të japë opinione
 - Studimi i mëparshëm mbi kontekstin duhet të ketë disa përgjigje apo hapa për të rekomanduar
 - Me kohën, më shumë njerëz do të mësojnë mbi këto hapa, megjithëse çdo rast ka veçantit e tij
- Vizitat shoqëruese bëhen atëherë kur këshillat nuk mjaftojnë, kur identifikohet një nevojë specifike, ose kur personi e ka provuar vetë dhe nuk ka sukses

Metodologjia dhe Struktura

Lehtësimi i mbledhjeve kolektive ka nevojë për rolet e mëposhtme:

- 1 person për fjalën e “mirëseardhjes”
- 1 person për të shpjeguar “kush jemi”
- 1 person për të shpjeguar “hapat që merren në rastet e zakonshme”
- 1 person për të shpjeguar rëndësinë e shpërndarjes së materialeve
- 1 person të mbajë radhën e të folurit. Normalisht ky person mban dhe shënimet për njoftimet në website.

Metodologjia dhe Struktura

- 1 person të kontrollojë që anketa plotësohet saktë
- Të paktën 3 vetë të jenë prezent edhe nga mbledhjet e mëparshme dhe që duan të ndajnë eksperiencat e tyre, pikëpamjet dhe mendimet
- 1 ose më shumë veta për shoqërimet (preferohen 2 ose më shumë)

*Në fillim disa vetë mund të bëjnë më shumë se një rol, por idealja është të ketë sa më shumë ndarje rolesh

Cili është rezultati?

“Kufizimet apo sfidat e ndeshura në zbatimin e mbledhjeve kolektive duhet të kalohen përmes fuqizimit dhe mundësive të vetë iniciativës”



Cilët janë rezultatet?

- Fuqizim
- Transformim rolesh
- Krijim i njohurive kolektive
- Ndarje përgjegjësish
- Krijim i një rrjeti me mbështetje reciproke
 - Zgjat në kohë (vazhdimësi)
 - Transformon në të njëjtën kohë me ndryshimet historike (ndarje statike e çështjes).



Cilët janë rezultatet?

KUFIZIME / SFIDA

- Kontekst kompleks dhe ndryshues
- Cështje të pafundme
- Ne nuk kemi zgjidhje për cdo gjë!
- Vështirësia e arritjes përtej rasteve të zakonshme dhe të përbashkëta (jo çdo kush di për nismën) → fletëpalosje, punë komunikuese, etj.
- Ndërprerje të caktuara nga pjesëmarrësit
 - Vartësisht nga situata personale,
 - Vartësisht nga motivimi

Cilët janë rezultatet?

ANET E FORTA / MUNDESITE

- Njerëzit e prekur tashmë janë “ekspertë”
- Drejtpërdrejt, lidhur me realitetin në kohë reale, aftësi për të reaguar shpejt
- Të menduarit sëbashku për zgjidhje dhe strategji
 - “Cfarë vlen për mua mund ti vlejë dhe dikujt tjetër”, “e bëmë këtë dhe nuk na eci, ndaj duhet të provojmë diçka të re”, etj.
- Akumulim në kohë i njohurive, etj.
- Ndjesia e të qënurit pjesë e ‘rrjetit’, të një “familje”
 - Mbështetje emocionale & fuqizim kolektiv në vend të asistencializmit



Komunikimi me personat e prekur

Përmes videove, website dhe medias sociale

<https://www.youtube.com/watch?v=VelpStJ8uel>

www.pobresaenergetica.es

https://twitter.com/APE_Cat

ALIANÇA CONTRA LA POBRESA ENERGÈTICA

Català

INICI QUI SOM TENS DRETS! ACCIONS CRÒNIQUES DOCUMENTS PARTICIPA!

Volen tallar-te l'aigua, la llum o el gas? Segueix els nostres consells!

#DERECHOSCORTADOS

Últimes entrades

Tret de sortida de la ILP de mesures per
ica.es/descarregues/

ILP HABITATGE

Un país sense talls

Komunikimi me personat e prekur

Përmes fletëpalosjeve/posterave për shpërndarje në vendet kyçe:

- Markete
- Qendra shëndetësore
- Qendrat e asistencës
- Zyrat e shërbimit social
- Zyrat e punësimit
- Në dalje të zyrave të kompanive të shërbimit



Komunikimi me personat e prekur

Përveç ofrimit të këtyre materialeve në mbledhjet kolektive, **një herë në dy javë bëhet një mbledhje grupit të shpërndarjes së materialeve**, në një lagje të zgjedhur, për t'i dorëzuar materialet personalisht, drejtpërdrejt te njerëzit në rrugë, në tregjet, jashtë zyrave kryesore, etj., në mënyrë që të shpjegojnë më shumë detaje nëse është e nevojshme.



Pobresa Energètica
@APE_Cat

Aquest matí hem seguit amb la [#DifusióAPE](#) per donar-nos a conèixer a tots els barris de Barcelona. Hem penjat cartells i repartit fulletons al barri de [#SantMartí](#) de Barcelona. Entre totes fem força per acabar amb la [#PobresaEnergètica](#) 💡

[Traducir Tweet](#)




1:57 p. m. · 9 dic, 2019 · [Twitter Web App](#)

21 Retweets 23 Me gusta

Komunikimi me personat e prekur

Përmes dokumentave ose formave të dobishme që të ndihmojnë me termat dhe kufizimet teknike / burokratike

<https://pobresaenergetica.es/index.php/ca/passos-a-seguir/documents-utils>



ALIANÇA CONTRA LA POBRESA ENERGÈTICA

Inici Qui som? Passos a seguir Cròniques Mitjans Agenda Contacte

DOCUMENTS ÚTILS

Dilluns, 21 Octubre

Documents útils

1 - Llei 24/2015, del 29 de juliol, de mesures urgents per a afrontar l'emergència en l'àmbit de l'habitatge i la pobresa energètica.
151019_Doc-garantia-subm-basics-ILP.vf.pdf

Details Download

2 - Model per presentar a l'empresa si t'han tallat els subministraments bàsics o tens amenaça de tall (.doc)
151019_Doc-garantia-subm-basics-ILP.vf.doc

Details Download

3 - Sol·licitud informe de risc exclusió residencial a serveis socials (.doc)
151019 INFORME-Exclusio-Residencial-SSocials ILP.doc

Details Download

Segueix-nos a Facebook

Segueix-nos a Twitter

Segueix-nos a Youtube

Segueix-nos a Telegram



Youtube

10/10/2019...



Komunikimi me personat e prekur

Gjithashtu dhe “Libri i kuq” është një udhëzues për të rinjtë në mbledhjet kolektive.



Komunikimi me personat e prekur

Cfarë ka në “Librin e Kuq”?

- **Parimet e nismës:** të garantojnë shërbime bazë si energjia përmes fuqizimit
- **Konteksti** i modelit të energjisë në vend/rajon: shpjeguar thjesht, përmes shembujve dhe termave të kuptueshme
- **Kush jemi?** Shpjegim i shkurtër i atyre që drejtojnë nismën
- **Pse Mbledhje Kolektive?** Përfitimet e metodologjisë
- **Si të marresh pjesë?** Mënyrat e pjesëmarrjes në nismë
- **Rastet e zakonshme:** përmbledhje e 4-5 rasteve dhe situatave më të zakonshme dhe hapat për tu ndjekur

Komunikimi me personat e prekur

Përse shëben “Libri i Kuq”?

- Është një udhëzues, **strukture e shkruar** e asaj që ndodh në realitet. Vecanërisht për ato që vijnë për here të pare në mbledhjet kolektive, është shumë e dobishme ta marrin me vete (mbahet në xhep) dhe ta kthejnë më vonë;
- Është një **kujtesë e hapave bazë** që ndërmerren në rastet e zakonshme. Kur ndonjëri ka dyshime, aty gjen përmbledhje të veprimeve për tu ndërmarrë;
- Është një “**manifest**” sesi funksionon një Mbledhje Kolektive dhe sesi lehtësohet (rregullat e lojës).



EmpowerMed

Faleminderit!

Trajnim mbi Mbledhjet Kolektive